



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P 530/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.07.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k. nga procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-02925-04-05-2017, me objekt “*Blerje pulla kontrolli me element sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre*”, me fond limit 12,022,823 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 02.05.2017 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjeksores.

Ankimues:

Albdesign PSP sh.p.k
Rruga Cerciz Topulli, nr.17 Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjeksores
Rruga “Dibrës”, Nr. 359/1 Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë, 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky operator i ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 06.04.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-02925-04-05-2017, me objekt: “Blerje pulla kontrolli me element sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre”, me fond limit 12,022,823 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 02.05.2017 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

II.2. Në datën 02.05.2017 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 17.05.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultojnë si më poshtë vijon:

- Ekspo Sistem	Pa ofertë	I skualifikuar
- Ilar	7,335,800 lekë pa tvsh	I skualifikuar
- Adel Co	9,142,530 lekë pa tvsh	I kualifikuar
- Kristalina-KH	9,469,938 lekë pa tvsh	I skualifikuar
- Albdesign PSP	10,368,900 lekë pa tvsh	I skualifikuar

II.4. Në datën 17.05.2017 operatori ekonomik “Albdesign PSP” shpk, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

Oferta juaj refuzohet për arsye se nuk keni përmbushur kriteret e përcaktuara në DST:

- *Kopje të certifikuara të bilanceve, të tre viteve të fundit financiar, të paraqitura në autoritetet përkatëse. Nga ana juaj rezultojnë se janë dorëzuar të konfirmuara nga organet tatimore, “Pasqyrat Financiare për vitin 2015 dhe vitin 2016”.*
- *Kopje të deklaratave të xhiros vjetore (të tre viteve të fundit), ku vlera të jetë jo më e vogël se fondi limit që prokurohet. Nga ana juaj rezultojnë se është dorëzuar “Vërtetim me nr. 5172/1 prot, datë 14.02.2017, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë që konfirmon xhiron vjetore për vitet 2015 dhe 2016.*
- *Specifikimet teknike: Mospërputhshmëria e kampionëve të dorëzuar me specifikimet teknike të kërkuara në DST, në përfundim të fazës së vlerësimit teknik, përbën kusht skualifikimi. Mostrat e mallrave që kërkohen të prokurohen, të paraqitura nga ju nuk janë në përputhje me specifikimet teknik. Konkretisht: “Përshkrimi – numrit 9 shifror progresiv të përcaktuar në DST: “Në krahun e majtë të pullës në mënyrë vertikale do të vendoset një numër 9 shifror progresiv, i cili duhet të fillojë nga 000000001 dhe do të jetë në rritje. Numri do të jetë me ngjyrë Blu Reflex, lloji i shkrimit të numrit Times Neë Roman, gjërsia e numrit 1.2 mm dhe gjatësia 8 mm”. Në kampionin e dorëzuar të pullës, numri 9(nëntë) shifror progresiv rezultojnë i vendosur vertikalisht në krahun e djathtë të pullës në kundërshtim me specifikimet e kërkuara.*
- *Funksionimit të të përcaktuar në shtojcën 10 të DST-ve “Funksionimi: Prodhimi i pullave do të bëhet në rulon që lejon përdorimin e makinave automatike dhe manuale. Kampionët e dorëzuar të “shiritave të printimit” dhe rulonët mbledhës janë të përshtatshëm për tu vendosur në makinën e printimit. Shiritat e printimit (kampionë) nuk realizojnë procesin e stampimit mbi pullë dhe printimin e produktit të gatshëm. Kampionët e dorëzuar të pullave dhe rulonët mbledhës janë të përshtatshëm për tu vendosur në makinën e printimit. Kampionët nuk e realizojnë procesin e stampimit të të dhënave mbi pullë (duke përdorur shiritat aktual të printimit që ka në përdorim autoriteti kontraktor). Niveli i realizimit të printimit të produktit të gatshëm nuk është në përputhje me kërkesat e A.K*

II.4.1. Në datën 22.05.2017 operatori ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij të dhëna nga autoriteti kontraktor. Konkretisht ankimuesi në ankesën e tij pretendon si më poshtë:

- *Shoqëria jonë është themeluar në datën 17.06.2015, dhe data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKB) është 19.06.2015, e verifikueshme kjo referuar Ekstraktit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Nisur nga kjo datë ka filluar edhe aktiviteti i kësaj shoqërie dhe i gjithë dokumentacioni që disponon kjo shoqëri fillon pikërisht nga kjo datë dhe nga ky vit pra nga data 19.06.2015. Në dokumentat e tendërit është kërkuar nga autoriteti kontraktor kriteri: "Kopje të certifikuara të bilanceve, të tre viteve të fundit financiar, të paraqitura në autoritetet përkatëse". Nga ana shoqërisë sonë është paraqitur bilanci i vitit 2015 dhe i vitit 2016, pra i dy viteve të fundit, vite në të cilat vërtetohet edhe ekzistenca e shoqërisë sonë sipas ekstraktit të QKB. Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Vertetimi me Nr. 5172/1 Prot., datë 14/2/2017 lëshuar nga administrata tatimore ku konstatohet se xhiro për vitin 2015 është në shumën 71.210.928 lekë dhe për vitin 2016 është në shumën 203.845.053 lekë. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithëcka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin ekonomik dhe financiar, e konkretisht të ketë bilance për tre vitet e fundit, por referuar nenit 46 të LPP, **"kur ky informacion është i mundur"**, pra në kushtet kur kjo shoqëri është krijuar në vitin 2015 nuk ka mundësi sesi të paraqesë bilanc për vitin 2014, vit gjatë të cilit as nuk ka ekzistuar dhe as nuk ka ushtruar aktivitet, ndaj nuk mund të paraqesë dokumentacion për një vit gjatë të cilit nuk ka qenë i krijuar dhe nuk ka ushtruar aktivitet.*
- *Së dyti; Në lidhje me xhiron sqarojmë se qëndron argumentimi i mësipërm në lidhje me xhiron e vitit 2014, pasi nuk kemi qenë krijuar si shoqëri në vitin 2014 dhe nuk mund të kemi dokument për krijim të ardhurash gjatë këtij viti, pasi jemi krijuar në vitin 2015 sipas ekstraktit të QKR. Akoma me tej, referuar dokumentacionit të paraqitur, bazuar edhe në interpretimet dhe vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik, xhiro mesatare e paraqitur nga ana e shoqërisë sonë për tre vitet e fundit, duke e konsideruar në vlerën 0 lekë xhiron për vitin 2014 në përllogaritje të mesatarës, për shkak të mosekzistences dhe rrjedhimisht mosushtrimit të aktivitetit në këtë periudhë, e tejkalon bindshëm disa herë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi (i cili është në vlerën 91.685.327 leke), duke e përmbushur njëkohësisht edhe kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentat*

e tenderit. Sqarojme se autoriteti kontraktor nuk ka qëllim në vetvete për ti kapur një gabim operatorit ekonomik e për ta skualifikuar atë, por qëllimi i autoritetit kontraktor është për të njohur gjëndjen financiare të operatorëve ekonomike dhe mundësinë e tyre për përmbushjen me suksesetë kontratës me kapacitetet që ka, gjë që përmbushet më së miri nga ana e shoqërisë sonë, si për bilancin ashtu edhe për xhiron. Kriteri i xhiros mesatare vjetore (për 1, 2 apo 3 vitet e fundit), sikundër edhe ai për kopje të bilanceve nuk janë qëllime në vetvete, por janë element referues të cilët i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar bindjen se operatori ekonomik konkurrues ka kapacitete financiare dhe rëndësi për përmbushjen me sukses të kontratës. Këto dy elementë, janë element referues dhe njohës, të cilët, në kuptim të legjislacionit mbi prokurimin publik, konsiderohen të nevojshëm posacërisht për të krijuar bindjen e autoritetit në lidhje me sa mësipër.

- Së treti: Në lidhje me arsyen e skualifikimit për mostrat sqarojmë se edhe kjo arsye skualifikimi e dhënë nga autoriteti kontraktor nuk qëndron bazuar kjo në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik si edhe në vendimarrjet e Komisionit të Prokurimit Publik.

Në dokumentat e tenderit në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik nga autoriteti kontraktor është kërkuar “dëshmia e origjinalitetit të mostrave”

Operatorët ekonomikë të dorëzojnë mostra të mallit objekt prokurimi, për secilin nga artikujt e listës, sipas specifikimeve teknike të dokumentave të tenderit. Mostrat e mallrave që kërkohen të prokurohen:

- | | | |
|----|--|-----------------|
| 1. | Rulon me jo më pak se 200 pulla në shirit | 1 (nje) copë. |
| 2. | Shirit stampimi termik | 1 (nje) copë. |
| 3. | Rulon kartoni mbledhës për pulla | 4 (kater) copë. |
| 4. | Rulon kartoni mbledhës për shirit printimi | 4 (kater) copë. |

Autoriteti Kontraktor kërkon mostra të mallrave që do të prokurohen, pasi gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat e mallrave do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë ekskluzivisht në kontroll të Autoritetit Kontraktor. Mostrat do të dorëzohen të futur në një zarf jo transparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e ofertuesit dhe të shënuar: "Ofertë për furnizimin e "Blerje pulla kontrolli me elementë sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre", Nr e Njoftimit, "MOS E HAPNI, ME PERJASHTIM TE RASTEVE KUR ESHTË I PRANISHEM KOMISIONI I VLERESIMIT TE OFERTES, DHE JO PARA dates 02.05.2017 ora 13:30". Mostrat e paraqitura mund t'i kthehen ofertuesit me kërkesën e tij, 30 ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kushtë që kontrata në fjalë të mos jetë objekt shqyrtimi administrativ apo gjyqësor. Në rast se procedura e prokurimit do të anulohet, kampionet e mallrave do ti kthehen ofertuesit me kërkesën e tij, brënda 30 diteve nga marrja e vendimit përfundimtar të anulimit. Mos paraqitja e këtyre kampionëve, dhe mosparaqitja e tyre në mënyrën e duhur apo mosparaqitja e tyre në përputhje me specifikimet teknike të DST përbën kushtë skualifikimi. Nga ana e shoqërisë sonë janë

dorëzuar të gjitha mostrat e kërkuara. Gjithashtu nga ana shoqërisë sonë është paraqitur edhe "Deklarate mbi përrnbushjen e specifikimeve teknike", e detyrueshme për t'u plotësuar nga operatorët ekonomike pjesërnarrës në këtë procedurë prokurimi sipas formatit të kërkuar nga autoritetit kontraktor, si angazhim i joni konkret për furnizimin e mallrave me të njëjtat specifikime teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe rrundësive operatorit për përrnbushjen me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Nisur nga sa mësipër, gjykojmë se pretendimi i autoritetit kontraktor se mostrat e paraqitura të artikujve dhe materialeve nga shoqëria jonë, nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit nuk qëndron, pasi për autoritetin kontraktor është e domosdoshme dhe e rëndësishme të vërtetohet që një operator ekonomik plotëson kriteret e kërkuara, për sa kohe ato janë në përputhje dhe në përpjestim me përmasat dhe natyrën e objektit që prokurohet. Gjykojmë se autoriteti kontraktor mund të kërkojë operatorëve ekonornike të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale të përcaktuara në dokumentat e tenderit, të tilla si mostra të mallit apo kataloge teknike kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertes teknike sikundër është kërkuar në këtë procedurë prokurimi dhe është plotësuar më së miri nga shoqëria jonë. Me dokumentacionin e paraqitur, shoqëria jonë provon se është e aftë të furnizojë produktet e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Gjithashtu ne konfirmojmë se jemi në gjëndje të furnizojmë produktet siç është kërkuar nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike të dokumentave të tenderit. Mostra, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të prodhuar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor, gje e cila vërtetohet plotësisht sipas dokumentacionit dhe mostrave të paraqitura nga shoqëria jone. Sqarojmë gjithashtu, se nuk ka kuptim që mostra të paraqitet e njëjtë ashtu siç është kërkuar në dokumentat e tenderit pasi së pari për produktin e prodhuar sipas të gjitha të dhënave të autoritetit kontraktor duhet edhe konfirmimi i tij si autoritet për të prodhuar një produkt të tillë që është me element sigurie, dhe nga ana tjetër nuk ka kuptim që mostra të jetë identike me atë të produktit përfundimtar pasi atëherë humbet edhe koncepti i fjalës mostër që nuk është e thënë që të jetë e njëjtë dhe identike me produktin final që kërkon autoriteti kontraktor. Mostra gjithashtu nuk mund të jetë identike, në kushtet kur nga ana e autoritetit kontraktor nuk janë vënë në dispozicion të gjitha fileat finale me të dhënat e kërkuara, por janë të ngjashme duke respektuar të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit. Mostra është një element më shumë që i shërben autoritetit kontraktor për të parë që një operator është i aftë të prodhojë produkte sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, me element sigurie e të dhëna të tjera. Nuk është e justifikuar fakti që mostra duhet të jetë identike pasi nëse paraqitet një mostër që përmban disa elementë si ata të kërkuar nga autoriteti kontraktor


nuk është shkak për skualifikim nga procedura, psh nuk është shkak skualifikimi se një numër nuk është vendosur në krahun e majtë por në atë të djathtë, ndërkohë që ajo është një mostër dhe ashtu siç është vendosur në krahun e djathtë mund të vendoset edhe në krahun e majtë, po e rëndësishme është që ajo nuk duhet të jetë identike dhe e njëjtë, por duhet të jetë e tillë që të vërtetojë se operatori është i aftë të prodhojë një produkt të tillë. Theksjomë për më tepër se ky testim i këtyre kampionëve nuk është bërë në prani të operatoreve ekonomik.

- *Gjithashtu kërkojme të sjellim në vëmendje të autoritetit kontraktorë se operatori ekonomik “Adel Co” i kualifikuar i vetëm në këtë procedurë prokurimi, ka paraqitur në tendër dokumenta fallco dhe jo ligjorë sikurse janë faturat e makinerive të paraqitura.*

II.5. Në datën 25.05.2017, me shkresën nr. 2363/25 prot, operatori ekonomik ankimues “Albdesign PSP” sh.p.k., është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.6. Në datën 02.06.2017, operatori ekonomik ankimues “Albdesign PSP” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr.2363/31 prot., datë 08.06.2017 protokolluar me tonën me nr.1050/3 datë 12.06.2017 me objekt “Dërgohet informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.



III

Public Health Sector

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Albdesign PSP” sh.p.k për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “*Specifikimet teknike: Mospërputhshmëria e kampionëve të dorëzuar me specifikimet teknike të kërkuara në DST, në përfundim të fazës së vlersimit teknik, përbën kusht skualifikimi. Mostrat e mallrave që kërkohen të prokurohen, të paraqitura nga ju nuk janë në përputhje me specifikimet teknik. Konkretisht: “Përshkrimit – numrit 9 shifror progresiv të përcaktuar në DST: “Në krahun e majtë të pullës në mënyrë vertikale do të vendoset një numër 9 shifror progresiv, i cili duhet të fillojë nga 000000001 dhe do të jetë në rritje. Numri do të jetë me ngjyrë Blu Reflex, lloji i shkrimit të numrit Times Neë Roman, gjërsia e numrit 1.2 mm dhe gjatësia 8 mm”. Në kampionin e dorëzuar të pullës, numri*

9(nëntë) shifror progresiv rezulton i vendosur vërtikalisht në krahun e djathtë të pullës në kundërshtim me specifikimet e kërkuara., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në Kreun II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 1 i “Hartimi i ofertës” i dokumentave standarte të tenderit parashikohet shprehimisht:

“Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”.

III.1.2. Në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.3 Dëshminë e origjinalitetit të mostrave, të dokumentave të tenderit të procedurës objekt ankimi, nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

Operatorët ekonomikë të dorëzojnë mostra të mallit objekt prokurimi, për secilin nga artikujt e listës, sipas specifikimeve teknike të dokumentave të tenderit.

Mostrat e mallrave që kërkohen të prokurohen:

1. Rulon më jo më pak se 200 pulla në shirit - 1(nje) copë.
2. Shirit stampimi termik - 1(nje) copë.
3. Rulon kartoni mbledhes per pulla - 4(kater) copë.
4. Rulon kartoni mbledhes per shirit printimi - 4(kater) copë.

Autoriteti Kontraktor kërkon mostra të mallrave që do të prokurohen, pasi gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat e mallrave do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë ekskluzivisht në kontroll të Autoritetit Kontraktor. Mostrat do të dorëzohen të futur në një zarf jotransparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: “Ofertë për furnizimin e “Blerje pulla kontrolli me elemente sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre”, Nr e Njoftimit, “MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS, DHE JO PARA datës 02.05.2017 ora 13.30”. Mostrat e paraqitura mund t’i kthehen ofertuesit me kërkesën e tij, 30 ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jete objekt shqyrtimi administrativ apo gjyqësor. Në rast se procedura e prokurimit do të anulohet, kampionet e mallrave do ti kthehen ofertuesit me kërkesën e tij, brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit përfundimtar të anulimit.

Mos paraqitja e këtyre kampioneve, mosparaqitja e tyre në mënyrën e duhur apo mosparaqitja e tyre në përputhje me specifikimet teknike të DST përbën kusht skualifikimi.

III.1.3. Në shtojcën 10 “Specifikimet Teknike” të dokumentave standarde të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar:

Specifikimi i Materialeve:

1-Artikulli: Pulla kontrolli me elemente sigurie për barna.

Përshkrimi: Pullat duhet të jenë të ndara nga njëra tjetra, të vendosura në qendër, distanca midis tyre 3 mm, të ngjitura në rulon letër.

Funksionimi: Prodhimi i pullave do të bëhet në rulon që lejon përdorimin e makinave automatike dhe manuale.

Permasat: Dimensionet e etiketës janë 25 x 14.5 mm, me cepa të rrumbullakosura.

a) Karakteristika të materialit përbërës:

1. Etiketa

Letër e bardhë pa dru e patinuar nga njëra anë me lluster. Letra të ketë sipërfaqe të shkëlqyeshme e përshtatshme për shtypje me shumë ngjyra, me precizion.

Pesha 78 gr/m²

Spesori 68mikron

Bardhësia 90%

Opaciteti 90%

Shkëlqyeshmëria 84%

Këputja në drejtim MD e CD 8-4 kg/15 mm

2. Adezivi

Nga prapa pulla të ketë adeziv të qëndrueshem akrilik i përshtatshëm për një gamë të gjerë të etiketave të natyrës që kërkojnë (pulla) dhe i aplikueshëm për ndryshime të mëdha të temperaturës.

Ngjitja të jetë e fortë pra permanente ku në 60 minuta pas ngjitjes të jetë e pashqitshme. Qëndrueshmeria e këputjes të jetë 480m.

Koha e aftësisë ngjitëse 1 orë minimale

Temperatura e aplikimit +5 °C

Variacion temperature në përdorim -20 deri në +80 °C

3. Letra mbajtëse ku vendosen pullat

Leter super kalandruar monosilikon

Pesha 61 gr/m²


Spesori 55 mikron

Transparenca 49 %

Qëndrueshmeria në këputje 80 deri në 40 N/15 mm

b) Përshkrimi:

I gjithë sfondi i etiketës duhet të jetë me një motiv (tip filigrane mijëra pikëshe), shtypur me ngjyrë Pantone 577 U, e sfumuar nga jashtë brenda. Pulla do të përfshijë të stampuar; **a)** Në krye të saj,



në sfond të shkrimit duhet të ketë: një motiv tip filigrane me valëzim me dimension 25 mm x 3 mm, me bojë UV me ngjyrë Blu Reflex e sfumuar në drejtim vertikal, si dhe shkrimin: MINISTRIA E SHËNDETËSISË me dimension 20 mm x 1 mm, me karakter Times Neë Roman (kapitale), të qëndëruara, shtypur, mbi motivin e valëve, me ngjyrë Blu Reflex; **b)** Në fund të saj, në sfond të shkrimit duhet të ketë: një motiv tip filigrane me valëzim me dimension 25 mm x 3 mm, me bojë UV me ngjyrë Blu Reflex e sfumuar në drejtim vertikal, si dhe shkrimin AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE me dimension 24 mm x 1 mm, me karakter Times Neë Roman (kapitale), të qëndëruara, shtypur, mbi motivin e valëve, me ngjyrë Blu Reflex; **c)** Në krahun e majtë të pullës në mënyrë vërtikale do të vendoset një numër 9 shifror progresiv, i cili duhet të fillojë nga 000000001 dhe do të jetë në rritje. Numri do të jetë me ngjyrë Blu Reflex, lloji i shkrimit të numrit Times Neë Roman, gjërësia e numrit 1.2 mm dhe gjatësia 8 mm.

c) Elemente sigurie:

- Në dy cepa të etiketës me koordinata: 1,5 mm x 11,5 mm dhe 23,5 mm x 11,5 mm, duhet të ketë dy elemente sigurie (stema e farmacisë gjarpër në gotë), me dimension 2 mm x 2 mm, shtypur me bojë të tejudkshme që fluoroshon ngjyrë të verdhë nën dritën e llampës ultravioletë.
- Në pjesën e sipërme, nën shkrimin MINISTRIA E SHËNDETËSISË, duhet të ketë elemente sigurie në formë drejtkëndëshi me dimension 20 mm x 1 mm, shtypur me bojë të tejudkshme që fluoroshon ngjyrë të verdhë nën dritën e llampës ultravioletë.
- Në pjesën e poshtme, mbi shkrimin AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE, duhet të ketë elemente sigurie në formë drejtkëndëshi me dimension 20 mm x 1 mm, shtypur me bojë të tejudkshme që fluoroshon ngjyrë të verdhë nën dritën e llampës ultravioletë.
- Midis dy motiveve poshtë e lart, duhet të ketë një hapësirë bosh (sfond) me bojë UV me ngjyrën e percaktuar si në piken 1, prej 8mm, e mjaftueshme për të shtypur tekstin, me leter termo transfertë.

d) Ambalazhi

Pullat duhet të jenë në rulon me përmasa: 40mm diametri i brendshëm dhe jo më e madhe se 200mm diametri i jashtëm; duhet të ketë në fund të shiritit të ngjitur në mënyrë të sigurt etiketën specifikuese, për sasinë e pullave në rulon. Të jenë të paketuara dhe të ambalazuara në kuti, në mënyrë të tillë që të jetë e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen nga faktorë të jashtëm. Kutia nuk duhet të peshojë më shumë se 25 kg.

e) Etiketimi

Do të përfshijë në shqip sasinë për çdo njësi ambalazhi (ruloni numrin e pullave, kuti/kolia numrin e rulonave)

2- Artikulli : Shirita stampimi termik :

a) Karakteristikat:

Shiriti i printimit të jetë i standartit universal, i përshtatshëm për printim në letër me shtresë të shkëlqyeshme, (gloss coated). Për printerat që disponojmë, shiriti termotransfertë mund të jetë i ngjashëm me tipin Ëax/resin.

Shiriti duhet të ketë rezistencë të lartë kundrejt gërvishtjeve, tretësve të ndryshëm dhe veti stampuese shumë të mira.

- Densiteti optik i shiritit 0.9 në transmetim
- Densiteti optik (reflektimi) 1.70 në reflektim

b) Ambalazhi

Shirit i stampimit të jetë i mbledhur në rulona me gjatësi 360-460 m dhe gjerësi 30 mm, diameter i brendshëm i unazës së kartonit të jetë 25mm, të përdorshëm për **cab printer**, të paketuara në kuti mënyrë të tillë që të jetë e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen nga faktorë të jashtëm.

c) Etiketimi

Do të përfshijë në shqip sasinë për cdo njësi ambalazhi (kuti/kolia numrin e shiritave)

3-Artikulli Rulona kartoni :

a) për mbledhjen e pullave, me gjerësi 30 mm, diameter të brendshëm unazës së kartonit 40mm, e përshtatshme për pajisjet e printimit të tipit cab printer A3-2/300R; **b)** për mbledhjen e shiritave të printimit, me gjerësi 30mm, diameter të brendshëm të unazës së kartonit 25mm;

a) Ambalazhi

Të jenë të paketuara dhe të ambalazuara në kuti, në mënyrë të tillë që të jetë e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen nga faktorë të jashtëm.

b) Etiketimi

Do të përfshijë në shqip sasinë për cdo njësi ambalazhi (kuti/kolia numrin e rulonave)

3. Kushte të përgjithshme;

Autoriteti Kontraktor (AKBPM-ja) disponon të drejtën e autorësisë së produktit për sa i përket specifikimeve teknike dhe dizenjimit.

Oferta duhet të shoqërohet me: kampione të mallrave që kërkohen të prokurohen: Rulon me jo më pak se:

1. 200 pulla në shirit – 1 (një) copë,
2. shirit printimi – 1 (një) copë,
3. Rulon kartoni për mbledhjen e pullave -4 (katër) copë,
4. Rulon kartoni për mbledhjen e shiritit të printimit -4 (katër) copë

Kampionet duhet të dorëzohen të futur në një zarf jotransparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit (Zyra e Protokollit AKBPM, Kati i Parë, Rruga e Dibrës, Nr.359/1, Tiranë) dhe të shënuar: “Ofertë për furnizimin e “Blerje pulla kontrolli me elemente sigurie për barna dhe aksesori për shtypjen e tyre”, Nr e Njoftimit, “MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS, DHE JO PARA data 02.05.2017 ora 13.³⁰”.

Lista e informacionit Konfidencial sipas shtojcës 5 te DST, për kampionet që do të dorëzohen, të plotësohet dhe të paraqitet në rrugë elektronike nga ofertuesi.

Mos paraqitja e këtyre kampioneve apo mospërputhshmëria e tyre me specifikimet teknike të kërkuara në DST, në përfundim të fazës së vlerësimit teknik, përbën kusht skualifikimi.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Në nenin 46, pika 2 përcaktohet: “Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë....”

III.1.5. Në nenin 27 “Kontratat e Mallrave”, të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 6, parashikohet shprehimisht: Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Autoriteti kontraktor, në mbështetje të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” dhe duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohet, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin raport analizat për artikujt objekt prokurimi.

Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në përcaktimin/apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brënda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë:

- (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe
- (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Synimi i autoritetit kontraktor lidhet drejtpërdrejtë me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderi.

III.1.8. Komisioni sqaron se autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale të përcaktuara në dokumentat e tenderit, të tilla si mostra të mallit apo kataloge teknike kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike sikundër është kërkuar në këtë procedurë prokurimi. Nisur nga sa mësipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, pretendimi i autoritetit kontraktor se mostrat e paraqitura të artikullit (pulla) nga operatori ekonomik ankimes, nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit qëndron, pasi për autoritetin kontraktor është e domosdoshme dhe e rëndësishme të vërtetohet që një operator ekonomik plotëson kriteret

e kërkuara, për sa kohë ato janë në përputhje dhe në përpjesëtim me përmasat dhe natyrën e objektit që prokurohet.

Nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se operatori ekonomik ankimues nuk është i aftë të ofrojë produktet e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Mostrat referuar edhe legjislacionit në fuqi- i shërbejnë autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor, gjë e cila në rastin konkret nuk vërtetohet nëpërmjet mostrave të paraqitura nga ankimuesi duke patur parasysh se mostrat e paraqitura nuk përmbushin karakteristikat siç kërkohet shprehimisht në specifikimet teknike.

III.1.9. Së fundmi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, skualifikimi nga autoriteti kontraktor i operatorit ekonomik ankimues “Albdesign PSP” sh.p.k është në përputhje të plotë me dispozitat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Albdesign PSP” sh.p.k nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Albdesign PSP” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, referuar gjykimit mësipër në pikën III.1.9., gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k. do të vijojë të ngelet e skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht pa ndonjë interes për ankimuesin.

Public Health Sector

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Albdesign PSP” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-02925-04-05-2017, me objekt “Blerje pulla kontrolli me element sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre”, me fond limit 12,022,823 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 02.05.2017 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit në përputhje me parashikimet e Vendimit nr.482 datë 05.07.2017 të Këshillit të Ministrave “Për Pezullimin e Përkohshëm të Procedurave të Prokurimit, për Vitin 2017”.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për shqyrtimin e mosmarrëveshjes administrative.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1050 Protokolli; Datë 02.06.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha



Public Health Sector